

III

(Aktet e miratuara sipas Traktatit të BE-së)

AKTET E MIRATUARA SIPAS TITULLIT VI TË TRAKTATIT TË BE-SË

VENDIMI KORNIZË I KËSHILLIT 2008/977/JHA

i 27 nëntorit 2008

për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara në kuadër të bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësisë në çështjet penale

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin mbi Bashkimin Evropian, e në veçanti nenin 30, 31 dhe 34(2)(b) të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni,

Duke pasur parasysh mendimin e Parlamentit Evropian,

Duke pasur parasysh që:

(1) Bashkimi Evropian i ka vënë vetes objektivin e mbajtjes dhe zhvillimit të Bashkimit si një zonë e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë ku duhet ofruar nivel i lartë i sigurisë me veprim të përbashkët midis shteteve anëtare në fushën e bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësisë në çështjet penale.

(2) Veprimi i përbashkët në fushën e bashkëpunimit të policisë sipas nenit 30(1)(b) të Traktatit mbi Bashkimin Evropian dhe veprimi i përbashkët për bashkëpunim gjyqësor në çështjet penale sipas nenit 31(1)(a) të Traktatit mbi Bashkimin Evropian nënkuptojnë nevojën e

përpunimit të informatave, të cilat duhen të nënshtrohen dispozitave të caktuara për mbrojtjen e të dhënave personale.

(3) Legjislacioni që bie brendapërbrenda fushëveprimit të Titullit VI të Traktatit mbi Bashkimin Evropian duhet ta nxisë bashkëpunimin e policisë dhe gjyqësisë në çështjet penale për sa i përket efikasitetit të vet, si dhe legjitimitetit dhe përputhjes me të drejtat fundamentale, në veçanti të drejtën për privatësi dhe për mbrojtjen e të dhënave personale. Standardet e përbashkëta lidhur me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale që përpunohen me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit, kontribuojnë në arritjen e të dyja qëllimeve.

(4) Programi i Hagës për përforcimin e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë në Bashkimin Evropian, i miratuar nga Këshilli Evropian më 4 nëntor 2004, ka theksuar nevojën për një qasje inovative për këmbimin ndërkufitar të informatave rreth zbatimit të ligjit nën vëzhgimin e rreptë të kushteve primare në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe e ka ftuar Komisionin që të paraqesë

propozimet në këtë aspekt më së voni deri në fund të vitit 2005. Kjo është reflektuar në Planin e Veprimit të Këshillit dhe Komisionit në zbatimin e Programit të Hagës për përforcimin e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë në Bashkimin Evropian.

(5) Këmbimi i të dhënave personale në kuadër të bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësisë në çështjet penale, veçanërisht sipas parimit të disponueshmërisë së informatave, siç është formuluar në Programin e Hagës, duhet mbështetur me rregulla të qarta që shtojnë besimin e ndërgjellët midis autoriteteve kompetente dhe që sigurojnë që informatat relevante mbrohen në atë mënyrë që përjashton çdo diskriminim në lidhje me atë bashkëpunim midis vendeve anëtare, gjersa respektojnë të drejtat fundamentale të individëve plotësisht. Instrumentet ekzistuese në nivel evropian nuk mjaftojnë; Direktiva 95/46/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 tetor 1995 mbi mbrojtjen e individëve për sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe për qarkullimin e lirë të të dhënave të tilla, nuk aplikohet në përpunimin e të dhënave personale në rrjedhën e një aktiviteti që bie jashtë fushëveprimit të Ligjit të Komunitetit (*organ traktatesh dhe legjislacioni*), siç janë ato të parapara me Titullin VI të Traktatit mbi Bashkimin Evropian, e as ndaj përpunimit të operacioneve që kanë të bëjnë me sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë shtetërore apo aktiviteteve të shtetit në fushat e të drejtës penale.

(6) Ky vendim kornizë aplikohet vetëm për të dhënat e grumbulluara apo përpunuara nga autoritetet kompetente me qëllim të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes

së veprave penale apo përmbushjes së dënimeve penale. Ky vendim kornizë duhet t'ia lëjë vendeve anëtare që në nivel nacional ta përcaktojnë më saktësisht se cilat qëllime tjera duhen marrë parasysh si të papërputhshme me qëllim për të cilin të dhënat personale ishin grumbulluar fillimisht. Në përgjithësi, përpunimi i mëtejshëm për qëllime historike, statistikore apo shkencore nuk duhet konsideruar si i papërshtatshëm me qëllimin fillestar të përpunimit.

(7) Fushëveprimi i këtij vendimi kornizë kufizohet në përpunimin e të dhënave personale të transmetuara apo të vëna në dispozicion midis shteteve anëtare. Nuk duhen nxjerrë konkluzione nga ky kufizim për sa i përket kompetencës së Bashkimit që ti miratojë aktet që lidhen me grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave personale në nivel nacional apo përshtatshmërisë për Bashkimin që të veprojë ashtu në të ardhmen.

(8) Për ta lehtësuar këmbimin e të dhënave brendapërbrenda Bashkimit, shtetet anëtare dëshirojnë të garantojnë që standardi i mbrojtjes së të dhënave i arritur në përpunimin nacional të të dhënave përputhet me atë që është paraparë me këtë vendim kornizë. Për sa i përket përpunimit nacional të të dhënave, ky vendim kornizë nuk i pengon shtetet anëtare që të ofrojnë kujdes më të madh në mbrojtjen e të dhënave personale sesa ato të krijuara në këtë vendim kornizë.

(9) Vendimi kornizë nuk duhet aplikuar ndaj të dhënave personale që një shtet anëtar i ka siguruar në kuadër të

fushëveprimi të këtij vendimi kornizë e që ka fillet në atë shtet anëtar.

(10) Përafrimi i ligjeve të shteteve anëtare nuk duhet të rezultojë me asnjëfarë pakësimi të mbrojtjes së të dhënave që ata mund ta përballojnë por duhet, në të kundërtën, të kërkojnë një nivel të lartë të mbrojtjes brendapërbrenda Bashkimit.

(11) Është e nevojshme të saktësohen objektivat e mbrojtjes së të dhënave brendapërbrenda kornizës së aktiviteteve të policisë dhe gjyqësisë dhe të formulojë rregullat lidhur me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale në mënyrë që të garantojë se çfarëdo informate që mund të këmbëhet të jetë përpunuar ligjshëm dhe në pajtim me parimet fundamentale që lidhen me cilësinë e të dhënave. Në të njëjtën kohë, aktivitetet legjitime të policisë, doganës, gjyqësisë dhe autoriteteve tjera kompetente nuk duhen rrezikuar në asnjë mënyrë.

(12) Parimi i saktësisë së të dhënave duhet aplikuar duke pasur parasysh natyrën dhe qëllimin e përpunimit në fjalë. Për shembull, sidomos në procedurat gjyqësore të dhënat bazohen në përceptimin subjektiv të individëve dhe në disa raste janë plotësisht të paverifikueshme. Si pasojë, kërkesa e saktësisë nuk mund ti përkasë saktësisë së deklarimit, por thjesht për faktin që është bërë deklarim i veçantë.

(13) Arkivimi në struktura të ndara të të dhënave duhet lejueshëm vetëm nëse të dhënat nuk kërkohen më dhe përdoren për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale apo zbatimin e dënimeve penale. Arkivimi në struktura të

ndara të të dhënave duhet të jetë i lejueshëm edhe nëse të dhënat e arkivuara ruhen në një bazë të të dhënave me të dhëna tjera në atë mënyrë që më nuk mund të shfrytëzohet për parandalimin, hetimin, zbulimin apo ndjekjen e veprave penale apo zbatimin e dënimeve penale. Përshtatshmëria e periudhës së arkivimit duhet varur nga qëllimet e arkivimit dhe interesat legjitime të subjekteve të të dhënave. Në rast arkivimi për qëllime historike, mund të parashihet periudhë shumë e gjatë kohore.

(14) Të dhënat mund edhe të fshihen duke asgjësuar mediumin (hapësirën e ruajtjes) e të dhënave.

(15) Për sa i përket të dhënave të pasakta, jo të plota apo të papërditësuara që transmetohen apo vihen në dispozicion të një shteti tjetër anëtar dhe që përpunohen më tej nga autoritetet kuazi-gjyqësore, që nënkupton autoritetet me fuqi për të sjellë vendime ligjërish të detyrueshme, korrigjimi i tyre apo bllokimi duhet kryer në pajtim me ligjin nacional.

(16) Garantimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale të individëve kërkon dispozita të përbashkëta për ta përcaktuar ligjshmërinë dhe cilësinë e të dhënave të përpunuara nga autoritetet kompetente në shtetet tjera anëtare.

(17) Është e udhës që të paraqiten kushtet në nivel evropian, sipas të cilave, autoritetet kompetente të shteteve anëtare duhen lejuar të transmetojnë dhe vënë në dispozicion të dhënat personale të marra nga shtetet tjera anëtare ndaj autoriteteve dhe palëve private në shtetet anëtare. Në shumë raste,

transmetimi i të dhënave personale nga gjyqësia, policia ose dogana ndaj palëve private është i nevojshëm për ta ndjekur krimin ose për ta parandaluar ndonjë kërcënim të atypëratyshëm dhe serioz ndaj sigurisë publike apo për të parandaluar dëmtimin serioz të të drejtave të individëve, për shembull, duke lëshuar alarme që kanë të bëjnë me falsifikime të kodeve të sigurisë së bankave dhe institucioneve të kredive ose, në fushën e kriminalitetit të automjeteve, duke i komunikuar të dhënat personale kompanive të sigurimit për ta parandaluar trafikimin e paligjshëm të automjeteve motorike të vjedhura apo për të përmirësuar kushtet për kthimin e automjeteve motorike të vjedhura nga jashtë. Kjo nuk është e barazvlefshme me transferimin e detyrave të policisë dhe gjyqësisë të palët private.

(18) Rregullat brenda vendimit kornizë lidhur me transmetimin e të dhënave personale nga gjyqësia, policia ose dogana të palët private nuk aplikohen në publikimin e të dhënave ndaj palëve private (siç janë avokatët mbrojtës dhe viktimat) në kontekst të procedimit penal.

(19) Përpunimi i mëtejshëm i të dhënave personale të pranuar, apo të vëna në dispozicion nga autoriteti kompetent i një shteti anëtar tjetër, në veçanti transmetimi i mëtejshëm apo vënia në dispozicion e të dhënave të tilla, duhet t'i nënshtrohet rregullave të përbashkëta në nivel evropian.

(20) Aty ku të dhënat personale mund të përpunohen më tej pasi shteti anëtar nga i cili janë marrë të dhënat të ketë dhënë pëlqimin e tij, secili shtet anëtar duhet të jetë në gjendje të përcaktojë modalitetet e një

pëlqimi të tillë, , përfshirë këtu, për shembull, nëpërmes pëlqimit të përgjithshëm për kategoritë e informatave apo kategoritë e përpunimit të mëtejshëm.

(21) Aty ku të dhënat personale mund të përpunohen më tej për procedura administrative, këto procedura përfshijnë edhe aktivitete të organeve rregullative dhe mbikëqyrëse.

(22) Aktivitetet legjitime të policisë, doganës, gjyqësisë dhe autoriteteve tjera kompetente mund të kërkojnë që të dhënat t'u dërgohen autoriteteve në shtetet e treta apo organeve ndërkombëtare që kanë obligime për parandalimin, hetimin, zbulimin apo ndjekjen e veprave penale ose zbatimin e dënimeve penale.

(23) Kur të dhënat personale transferohen nga një shtet anëtar të shtetet e treta apo organet ndërkombëtare, këto të dhëna, në parim, duhet të gëzojnë mbrojtje të nivelit adekuat.

(24) Kur të dhënat personale transferohen nga një shtet anëtar të shtetet e treta apo organet ndërkombëtare, një transferim i tillë, në parim, duhet të bëhet vetëm pasi që shteti anëtar, nga i cili janë marrë të dhënat, të ketë dhënë pëlqim për transferimin. Çdo shtet anëtar duhet të jetë në gjendje të përcaktojë modalitetet e një pëlqimi të tillë, përfshirë këtu, për shembull, nëpërmes pëlqimit të përgjithshëm për kategoritë e informatave apo për shtetet e treta të specifikuar.

(25) Interesat e bashkëpunimit në zbatimin efikas të ligjit kërkojnë që kur natyra e një kërcënimi ndaj sigurisë publike të një shteti anëtar apo një shteti të tretë është aq i

drejtpërdrejtë sa të bëhet e pamundur që të merret pëlqim paraprak me kohë, autoriteti kompetent duhet të jetë në gjendje t'ia transferojë të dhënat personale relevante shtetit të tretë në fjalë pa një pëlqim të tillë paraprak. E njëjta do të mund të aplikohet kur interesat tjerë thelbësorë të një shteti anëtar të së njëjtës rëndësi janë në rrezik, për shembull kur infrastruktura kritike e një shteti anëtar mund t'i nënshtrohet kërcënimit të drejtpërdrejtë dhe serioz apo kur sistemi financiar i një shteti anëtar mund të përçahet seriozisht.

(26) Mund të jetë e nevojshme të informohen subjektet e të dhënave lidhur me përpunimin e të dhënave të tyre, sidomos kur të ketë pasur shkelje serioze të të drejtave të tyre si rezultat i masave të fshehta të grumbullimit të të dhënave, në mënyrë që sigurohmi që subjektet e të dhënave të kenë mbrojtje ligjore efikase.

(27) Shtetet anëtare duhet të sigurohen që subjekti i të dhënave të informohet që të dhënat personale janë apo po grumbullohen, përpunohen ose transmetohen në një shtet anëtar me qëllim të parandalimit, hetimit, zbulimit dhe ndjekjes së veprave penale apo zbatimit të dënimeve penale. Modalitetet e të drejtës së subjektit të të dhënave për t'u informuar dhe përjashtimet me atë rast duhen përcaktuar me ligj nacional. Kjo mund të marrë formë të përgjithshme, për shembull, përmes ligjit ose përmes publikimit të një liste të veprimeve të përpunimit.

(28) Për ta garantuar mbrojtjen e të dhënave personale pa i rrezikuar hetimet penale, është e nevojshme të definohen të drejtat e subjektit të të dhënave.

(29) Disa shtete anëtare kanë paraparë për të drejtën në qasje të subjektit të të dhënave në çështjet penale përmes një sistemi ku autoriteti kombëtar mbikëqyrës në vend të subjektit të të dhënave, të ketë qasje në të gjitha të dhënat personale që lidhen me subjektin e të dhënave pa ndonjë kufizim dhe gjithashtu mund ta korrigjojë, fshijë apo përditësojë të dhënat e pasakta. Në rastet e tilla të qasjes indirekte, ligji nacional i atyre shteteve anëtare mund të parashohë që autoriteti mbikëqyrës kombëtar ta informojë subjektin e të dhënave vetëm që të jenë bërë të gjitha verifikimet e nevojshme. Megjithkëtë, ato vende anëtare poashtu parashohin mundësinë e qasjes së drejtpërdrejtë të subjektit të të dhënave në raste specifike, siç është qasja në shënime gjyqësore, për të marrë kopjet e shënimeve të veta penale apo të dokumentave që lidhen me dëgjimet e veta nga shërbimet policore.

(30) Parapëlqehet të krijohen rregulla të përbashkëta mbi konfidencialitetin dhe sigurinë e përpunimit, për detyrimin dhe dënimet e përdorimit të paligjshëm nga autoritetet kompetente dhe për kompensimet në dispozicion të subjektit të të dhënave. Sidoqoftë, i takon shteteve anëtare ta përcaktojnë natyrën e rregullave të veta dhe të dënimeve të aplikueshme ndaj shkeljeve të dispozitave vendore të mbrojtjes së të dhënave.

(31) Ky vendim kornizë mundëson që parimi i qasjes publike në dokumenta publikë të merren parasysh kur të zbatohen parimet e përcaktuara në këtë vendim kornizë.

(32) Kur të ketë nevojë të mbrohen të dhënat personale lidhur me përpunimin, i cili sipas shkallës dhe llojit bartë rreziqe specifike për të drejtat dhe liritë thelbësore, për shembull përpunimi nëpërmjet teknologjisë, mekanizmave dhe procedurave të reja, është e përshtatshme të sigurohemi që autoritetetnacionale kompetente për mbikëqyrje të konsultohen para krijimit të sistemit të dosjeve gjatë përpunimit të këtyre të dhënave.

(33) Krijimi në shtetet anëtare i autoriteteve mbikëqyrëse, që ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi të plotë, është komponentë thelbësore e mbrojtjes së të dhënave personale të përpunuara në kuadër të bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësisë midis shteteve anëtare.

(34) Autoritetet mbikëqyrëse veçse të krijuara në shtetet anëtare sipas Direktivës 95/46/EC duhet të jenë në gjendje të marrin përgjegjësi për detyrat që duhen kryer nga autoritetet mbikëqyrëse nacionale që duhen themeluar sipas këtij vendimi kornizë.

(35) Autoritetet e tilla mbikëqyrëse duhet të posedojnë mjetet e nevojshme për t'i kryer detyrat e tyre, përfshirë këtu autorizimin për hetim dhe intervenim, ose autorizimin për t'u angazhuar në procedura juridike. Këto autoritete mbikëqyrëse duhet të ndihmojnë që të sigurohet transparencë e procedurave në shtetet anëtare në kuadër të juridiksionit që bien. Sidoqoftë, autorizimet e tyre nuk duhet ndërhyrë me rregullat specifike të përcaktuara për procedurat penale apo pavarësinë e gjyqësorit.

(36) Neni 47 i Traktatit për Bashkimin Evropian përcakton që asgjë brenda tij nuk

duhet ndikuar në traktatet që themelojnë Komunitetet Evropiane apo traktatet dhe aktet pasuese që modifikojnë apo plotësojnë ato. Prandaj, ky vendim kornizë nuk dëmton mbrojtjen e të dhënave personale sipas ligjit të Komunitetit, veçanërisht siç parashihet me Direktivën 95/46/EC, me Rregulloren (EC) nr.45/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 18 dhjetor 2000 për mbrojtjen e individëve për sa i përket përpunimit të të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Komunitetit dhe mbi qarkullimin e lirë të dhënave të tilla, si dhe me Direktivën 2002/58/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 12 korrik 2002 që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike (Direktiva mbi privatësinë dhe komunikimet elektronike).

(37) Ky vendim kornizë nuk cenon rregullat që lidhen me qasjen e paligjshme në të dhënat e deklaruara në Vendimin Kornizë të Këshillit 2005/222/HA të 24 shkurtit 2005 për sulmet ndaj sistemit informativ.

(38) Ky vendim kornizë nuk cenon obligimet dhe përkushtimet ekzistuese që i takojnë shteteve anëtare apo Bashkimit për arsye të marrëveshjeve bilaterale dhe/ose multilaterale me shtetet e treta. Marrëveshjet e ardhshme duhet të përputhen me rregullat mbi këmbimin me shtetet e treta.

(39) Disa akte, të aprovuara mbi bazën e Titullit VI të Traktatit për Bashkimin Evropian, përmbajnë dispozita të veçanta mbi mbrojtjen e të dhënave personale të shkëmbyera apo ndryshe të përpunuara sipas këtyre akteve. Në disa raste këto

dispozita përbëjnë një tërësi të plotë dhe koherente të rregullave që mbulojnë të gjitha aspektet relevante të mbrojtjes së të dhënave (parimet e cilësisë së të dhënave, rregullat mbi sigurinë e të dhënave, rregullorja e të drejtave dhe ruajtjen e subjekteve të të dhënave, organizimi i mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë) dhe ato rregullojnë këto çështje më detajisht sesa ky vendim kornizë. Struktura relevante e dispozitave të mbrojtjes së të dhënave të atyre akteve, sidomos ato që rregullojnë funksionimin e Eurpol-it, Eurojust-it, Sistemit Informativ të Shengenit dhe Sistemit Informativ të Doganës, si dhe ato që paraqesin qasje të drejtpërdrejtë për autoritetet e shteteve anëtare për disa sistemeve të të dhënave të shteteve anëtare tjera, nuk duhen ndikuar nga ky vendim kornizë. E njëjta aplikohet për sa i përket dispozitave për mbrojtjen e të dhënave që rregullojnë transferimin automatik midis shteteve anëtare të profileve të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënat e regjistrimit nacional të automjeteve sipas Vendimit të Këshillit 2008/615/HA të 23 qershorit 2008 në ngritjen e bashkëpunimit ndërkufitar, veçanërisht në luftimin e terrorizmit dhe krimin ndërkufitar.

(40) Në rastet tjera dispozitat për mbrojtjen e të dhënave në aktet e miratuara në bazë të Titullit VI të Traktatit për Bashkimin Evropian, janë më të kufizuara në fushëveprim. Ato shpesh caktojnë kushte të veçanta për shtetet anëtare që pranojnë informata që përmbajnë të dhëna personale nga shtetet anëtare tjera për sa u përket qëllimeve për të cilat mund ti shfrytëzojë ato të dhëna, por që i referohen aspekteve tjera të mbrojtjes së të dhënave të Këshillit të

Konventës Evropiane për Mbrojtjen e Individëve për sa i përket Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale të 28 janarit 1981 apo të ligjit nacional. Deri në atë masë që dispozitat e atyre akteve që imponojnë kushtet rreth pranimit të shteteve anëtare për sa i përket përdorimit apo transferimit të mëtejme të të dhënave personale janë më kufizuese sesa ato të përfshira në dispozitat përkatëse të këtij vendimi kornizë, dispozitat e mëparme duhet të qëndrojnë të painfluencuara. Sidoqoftë, për të gjitha aspektet tjera, duhet të aplikohen rregullat e përcaktuara në këtë vendim kornizë.

(41) Ky vendim kornizë nuk ndikon në Këshillin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e Individëve për sa i përket Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale, Protokollin Shtesë të asaj Konvente të 8 nëntorit 2001 ose konventat e Këshillit të Evropës mbi bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale.

(42) Meqë objektivi i këtij vendimi kornizë, do të thotë përcaktimi i rregullave të përbashkëta për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara në kuadër të bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësisë në çështjet penale, nuk mund të arrihen mjaftueshëm nga shtetet anëtare, dhe prandaj, për shkak të shkallës dhe efekteve të veprimit, mund të arrihen më mirë në nivel të Bashkimit, i njëjti mund të miratojë masa në pajtim me parimet e vartësisë, siç është përcaktuar me nenin 5 të Traktatit që themelon Komunitetin Evropian dhe që i referohet nenit 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian. Sipas parimit të proporcionalitetit, siç përcaktohet në nenin 5 të Traktatit që themelon Komunitetin

Evropian, ky vendim kornizë nuk shkon përtej asaj që është e domosdoshme për ta arritur atë objektiv.

(43) Mbretëria e Bashkuar merr pjesë në këtë vendim kornizë sipas nenit 5 të Protokollit që integron *acquis* e Schengen-it brenda kornizës së Bashkimit Evropian të shtuar në Traktatin për Bashkimin Evropian dhe Traktatit që themelon Komunitetin Evropian, dhe nenit 8(2) të Vendimit të Këshillit 2000/365/EC të 29 majit 2000 për sa i përket kërkesës së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore për të marrë pjesë në disa nga dispozitat e *acquis* të Schengen-it.

(44) Irlanda merr pjesë në vendimin kornizë në pajtim me nenin 5 të protokollit që përfshinë *acquis* e Schengen-it brenda kornizës së Bashkimit Evropian të shtuar në Traktatin për Bashkimin Evropian dhe Traktatit që themelon Komunitetin Evropian, dhe nenin 6(2) të Vendimit të Këshillit 2002/192/EC të 28 shkurtit 2002 që ka të bëjë me kërkesën e Irlandës për të marrë pjesë në disa dispozita të *acquis* të Schengen-it.

(45) Për sa i përket Islandës dhe Norvegjisë, ky vendim kornizë përbën përmirësim të dispozitave të *acquis* të Schengen-it brenda kuptimit të Marrëveshjes së lidhur nga Këshilli i Bashkimit Evropian dhe Republikës së Islandës, si dhe të Mbretërisë së Norvegjisë për sa i përket shoqërimit të kësaj të fundit me zbatimin, aplikimin dhe zhvillimin e *acquis* të Schengen-it, i cili bie brendapërbrenda fushës së referuar në nenin 1, pikat H dhe I të Vendimit të Këshillit 1999/437/EC për disa rregullime për aplikimin e asaj Marrëveshjeje.

(46) Për sa i përket Zvicrës, ky vendim kornizë përbën një përmirësim të dispozitave të *acquis* të Schengen-it në kuptimin e Marrëveshjes midis Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane për asocijimin dhe zbatimin, aplikimin dhe zhvillimin e *acquis* të Schengen-it të Konfederatës Zvicerane, e cila bie në fushën e referuar në nenin 1, pikat H dhe I të Vendimit të Këshillit 1999/437/EC të interpretuar bashkë me nenin 3 të Vendimit të Këshillit 2008/149/JHA për konkluzionin e asaj Marrëveshjeje në emër të Bashkimit Evropian.

(47) Në lidhje me Liechtenstein-in, ky vendim kornizë përbën përmirësim të dispozitave të *acquis* të Schengen-it brenda kuptimit të Protokollit të nënshkruar midis Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian, Konfederatës Zvicerane dhe Principatës së Liechtenstein-it mbi hyrjen e Principatës së Liechtenstein-it në Marrëveshjen midis Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane për sa i përket shoqërimit të kësaj të fundit me zbatimin, aplikimin dhe zhvillimin e *acquis* të Schengen-it, e cila bie brendapërbrenda fushës së referuar në nenin 1, pikat H dhe I të Vendimit të Këshillit 1999/437/EC të interpretuar bashkë me nenin 3 të Vendimit të Këshillit 2008/262/JHA për nënshkrimin e atij Protokollit në emër të Bashkimit Evropian.

(48) Ky vendim kornizë respekton të drejtat thelbësore dhe vëzhgon parimet e pranuar në veçanti nga Karta e të Drejtave Fundamentale të Bashkimit Evropian. Ky vendim kornizë kërkon të garantohet respektimi i plotë për të drejtat në privatësi

dhe mbrojtje të të dhënave personale të reflektuara në nenin 7 dhe 8 të Kartës.

KA MIRATUAR KËTË VENDIM KORNIZË:

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij vendimi kornizë është që të garantojë nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive thelbësore të personave fizikë, dhe në veçanti të drejtën e tyre për privatësi, për sa i përket përpunimit të të dhënave personale në kuadër të bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësisë në çështjet penale, të parapara me Titullin VI të Traktatit për Bashkimin Evropian, duke garantuar nivel të lartë të sigurisë publike.

2. Në pajtim me këtë vendim kornizë, shtetet anëtare mbrojnë të drejtat dhe liritë thelbësore të personave fizikë, dhe në veçanti të drejtën e tyre në privatësi, atëherë kur me qëllim të parandalimit, hetimit, zbulimit apo ndjekjes së veprave penale ose zbatimit të dënimeve penale, të dhënat personale:

(a) transmetohen apo janë transmetuar ose vihen në dispozicion midis shteteve anëtare;

(b) transmetohen apo janë transmetuar ose vihen në dispozicion nga shtetet anëtare për autoriteteve apo për sistemet informative të krijuara në bazë të Titullit VI të Traktatit për Bashkimin Evropian; ose

(c) transmetohen apo janë transmetuar ose vihen në dispozicion të autoriteteve kompetente të shteteve anëtare nga autoritete apo sistemet informative të krijuara mbi bazën e Traktatit për

Bashkimin Evropian që krijon Komunitetin Evropian.

3. Ky vendim kornizë aplikohet te përpunimi i të dhënave personale plotësisht apo pjesërisht përmes pajisjeve automatike, dhe te përpunimi pa pajisje automatike, i të dhënave personale, që përbën pjesë të sistemit informativ ose që kanë për qëllim të formojnë pjesë të sistemit të dosjeve.

4. Ky vendim kornizë nuk paragjykon interesat esenciale të sigurisë nacionale dhe aktivitetet specifike të zbulimit në fushën e sigurisë nacionale.

5. Ky vendim kornizë nuk i pengon shtetet anëtare që për mbrojtjen e të dhënave personale të grumbulluara ose të përpunuara në nivel nacional, të ofrojnë ruajtje më të lartë sesa ato të krijuara në këtë vendim kornizë.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllime të këtij vendimi kornizë:

(a) 'të dhëna personale' nënkupton informatat që lidhen me një person fizik të identifikuar apo të identifikueshëm ('subjekt i të dhënave'); një person i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet, direkt apo indirekt, veçanërisht duke iu referuar një numri identifikues ose një apo më shumë faktorëve specifikë të identitetit të tij fizik, psikologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

(b) 'përpunim i të dhënave personale' dhe 'përpunim' nënkuptojnë cilindo veprim ose paketë veprimesh që kryhen ndaj të

dhënave personale, pavarësisht nëse bëhet me mjete automatike apo jo, siç është grumbullimi, regjistrimi, organizimi, ruajtja, adaptimi ose ndryshimi, korrigjimi, konsultimi, shfrytëzimi, publikimi përmes transmetimit, përhapja ose vënia në dispozicion në forma të ndryshme, grupimi apo kombinimi, bllokimi, fshirja ose asgjësimi;

(c) 'bllokimi' nënkupton shënjimën e të dhënave personale të ruajtura me qëllim të kufizimit të përpunimit të mëtejshëm të tyre;

(d) 'sistemi i dosjeve i të dhënave personale' dhe 'sistemi i dosjeve' nënkuptojnë çdo strukturë të të dhënave personale, të cilat janë të qasshme sipas kriterëve specifike, qoftë të centralizuar, decentralizuar ose shpërndarë në bazë funksionale ose gjeografike;

(e) 'përpunues' nënkupton çdo organ që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit;

(f) 'pranues' nënkupton çdo organ të cilit i jepen të dhënat;

(g) 'pajtim i subjektit të të dhënave' nënkupton çdo indikacion të vullnetit specifik dhe të informuar të dhënë lirshëm, përmes të cilit subjekti i të dhënave tregon pajtimin e tij për të dhënat personale në përpunim e sipër që lidhen me të;

(h) 'autoritetet kompetente' nënkupton agjencitë apo organet e krijuara me akte ligjore të miratuara nga Këshilli sipas Titullit VI të Traktatit për Bashkimin Evropian, si dhe policisë, doganës, gjyqësisë dhe autoriteteve tjera kompetente të shteteve anëtare që janë të autorizuara me

ligj nacional për të përpunuar të dhëna personale brendapërbrenda fushëveprimit të këtij vendimi kornizë;

(i) 'kontrollues' nënkupton personin fizik apo juridik, autoritet publik, agjenci ose çfarëdo organi tjetër, i cili si i vetëm apo bashkërisht me të tjerë përcakton qëllimet dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale;

(j) 'referim' nënkupton shënjimën e të dhënave personale të ruajtura pa qëllim të kufizimit të përpunimit të tyre në të ardhmen;

(k) 'bërja anonime' nënkupton modifikimin e të dhënave personale në atë mënyrë që hollësitë e rrethanave personale apo materiale nuk mundën apo vetëm me investim të pabarabartë kohor, që të kostoja apo puna të atribuohet më një personi fizik të identifikuar apo të identifikueshëm.

Neni 3

Parimet e Ligjshmërisë, Proporcionalitetit dhe Qëllimit

1. Të dhënat personale mund të grumbullohen nga autoritetet kompetente vetëm për qëllime të saktësuara, eksplicite dhe legjitime në kuadër të detyrave të tyre dhe mund të përpunohen vetëm për të njëjtin qëllim për të cilin janë grumbulluar të dhënat. Përpunimi i të dhënave është i ligjshëm dhe adekuat, relevant dhe jo i tepërt në lidhje me qëllimet për të cilat janë grumbulluar.

2. Përpunimi i mëtejshëm për qëllime tjera lejohet gjersa:

(a) nuk është i papërshtatshëm me qëllimin për të cilin janë grumbulluar të dhënat;

(b) autoritetet kompetente janë të autorizuar që të përpunojnë të dhëna të tilla për qëllime të tjera të tilla në pajtim me dispozitat e palikueshme ligjore; dhe

(c) përpunimi është i nevojshëm dhe proporcional me atë qëllim tjetër.

Autoritetet kompetente gjithashtu mund të përpunojnë mëtej të dhënat personale të transmetuara për qëllime historike, statistikore ose shkencore, me kusht që shtetet anëtare të ofrojnë ruajtjen e përshtatshme, siç është bërja anonime e të dhënave.

Neni 4

Korrigjimi, Fshirja dhe Bllokimi

1. Të dhënat personale korrigjohen nëse janë të pasakta dhe, aty ku është e mundur dhe e nevojshme, plotësohen ose përditësohen.

2. Të dhënat personale fshihen ose bëhen anonime atëherë kur nuk kërkohen më për qëllimet për të cilat janë grumbulluar në mënyrë të ligjshme ose janë përpunuar ligjshëm.

3. Të dhënat personale bllokohen në vend se të fshihen nëse ka bazë të arsyeshme të besohet se fshirja do të rezultonte interesat legjitime të subjektit të të dhënave. Të dhënat e bllokuara përpunohen vetëm për qëllime që parandalojnë fshirjen e tyre.

4. Kur të dhënat personale gjenden në vendim ose shkresë gjyqësore që ka të bëjë me lëshimin e një vendimi gjyqësor,

korrigjimi, fshirja ose bllokimi kryhet në pajtim me rregullat nacionale mbi procedurat gjyqësore.

Neni 5

Krijimi i Afateve Kohore për Fshirje dhe Rishikim

Afatet e përshtatshme kohore krijohen për fshirjen e të dhënave personale ose për rishikimin periodik i nevojës për ruajtjen e të dhënave. Masat procedurale garantojnë se këto kufizime kohore vëzhgohen.

Neni 6

Përpunimi i Kategorive të Veçanta të të Dhënave

Përpunimi i të dhënave personale që zbulojnë origjinën raciale apo etnike, mendimet politike, besimet fetare ose filozofike apo anëtarësinë në sindikata, si dhe përpunimin e të dhënave që kanë të bëjnë me shëndetin apo jetën seksuale, lejohet vetëm kur kjo është tejet e nevojshme dhe kur ligji nacional parasheh mbrojtje adekuate.

Neni 7

Vendimet Individuale të Automatizuara

Një vendim që prodhon efekt të kundërt ligjor për subjektin e të dhënave apo e ndikon atë në mënyrë domethënëse dhe që bazohet vetëm në përpunim automatik të të dhënave që kanë për qëllim vlerësimin e disa aspekteve personale që lidhen me subjektin e të dhënave, lejohet vetëm nëse autorizohet me ligj, që gjithashtu përcakton masat për ruajtjen e interesave legjitime të subjektit të të dhënave.

Neni 8

Verifikimi i Cilësisë së të Dhënave që Transmetohen apo Vihen në Dispozicion

1. Autoritetet kompetente ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm që të parashikojnë se të dhënat personale të pasakta, të paplota ose të papërditësuara të mos transmetohen ose vihen në dispozicion. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente, për aq sa është e praktikueshme, verifikojnë cilësinë e të dhënave personale para se të transmetohen ose vihen në dispozicion. Aq sa është e mundur, në të gjitha transmetimet e të dhënave, shtohen informatat në dispozicion që i mundësojnë shtetit anëtar pranues të vlerësojë shkallën e vërtetësisë, plotnisë, përditësimit dhe besueshmërisë. Nëse të dhënat personale janë transmetuar pa kërkesë, autoriteti pranues verifikon këto të dhëna pa vonesë nëse të njëjtat janë të nevojshme për qëllimin për të cilin janë transmetuar.

2. Nëse del që janë transmetuar të dhëna të pasakta apo që të dhënat janë transmetuar në mënyrë të paligjshme, pranuesi duhet të njoftohet pa vonesë. Të dhënat duhen korrigjuar, fshirë ose bllokuar pa vonesë në pajtim me nenin 4.

Neni 9

Afatet Kohore

1. Me rastin e transmetimit apo vënies në dispozicion të të dhënave, autoriteti transmetues, në përputhje me ligjin nacional dhe sipas nenit 4 dhe 5, mund të tregojë afatin kohor për ruajtjen e të dhënave, me skadimin e të cilit, pranuesi duhet të fshijë apo bllokojë të dhënat apo të rishikojë nëse

të njëjtat nevojiten ende. Ky obligim nuk aplikohet nëse, në kohën e skadimit të këtyre afateve kohore, të dhënat kërkohen për hetim aktual, ndjekje të veprave penale ose zbatim të dënimeve penale.

2. Në rastet kur autoriteti transmetues nuk ka dhënë afate kohore sipas paragrafit 1, aplikohen afatet kohore që i referohen nenit 4 dhe 5 për ruajtjen e të dhënave të parapara me ligjin nacional të shtetit anëtar pranues.

Neni 10

Regjistrimi dhe Dokumentimi

1. Të gjitha transmetimet e të dhënave personale duhen regjistruar apo dokumentuar për qëllime verifikimi të ligjshmërisë të përpunimit të të dhënave, vet-monitorimit dhe garantimit të paprekshmërisë dhe sigurisë së duhur të të dhënave.

2. Regjistri apo dokumentimi i përgatitur sipas paragrafit 1 komunikohet, me kërkesë, autoritetit mbikëqyrës për kontrollim të mbrojtjes së të dhënave. Autoriteti mbikëqyrës kompetent i shfrytëzon këto informata vetëm për kontroll të mbrojtjes së të dhënave dhe për garantimin e përpunimit të duhur të të dhënave si dhe paprekshmërinë dhe sigurinë e të dhënave.

Neni 11

Përpunimi i të Dhënave Personale të vëna në Dispozicion nga një Shtet Anëtar tjetër

Të dhënat personale të pranuar apo të vëna në dispozicion nga autoriteti kompetent i një shteti anëtar tjetër, në pajtim me kërkesat e nenit 3(2), mund të përpunohen vetëm për qëllimet në vijim,

përveç atyre që janë transmetuar apo vënë në dispozicion:

(a) parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale apo zbatimin e dënimeve penale përveç atyre për të cilat janë transmetuar ose vënë në dispozicion;

(b) procedurat tjera gjyqësore dhe administrative të lidhura me parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale ose zbatimin e dënimeve penale;

(c) parandalimin e një kërcënimi të atypëratyshëm dhe serioz për sigurinë publike; ose

(d) çfarëdo qëllimi tjetër vetëm me pëlqimin paraprak e shtetit anëtar që bën transmetimin ose me pëlqimin e subjektit të të dhënave, të dhënë në pajtim me ligjin nacional.

Autoritetet kompetente gjithashtu mund të përpunojnë të dhënat personale të transmetuara për qëllime historike, statistikore ose shkencore, me kusht që shtetet anëtar të ofrojnë ruajtjen e duhur, siç është për shembull, bërja e të dhënave anonime.

Neni 12

Pajtimi me Kufizimet Nacionale të Përpunimit

1. Në rastet kur, sipas ligjit të shtetit anëtar që bën transmetimin, aplikohen kufizime specifike të përpunimit në rrethana specifike ndaj këmbimit të të dhënave midis autoriteteve kompetente brendapërbrenda atij shteti anëtar, autoriteti transmetues informon pranuesin për kufizimet e tilla.

Pranuesi sigurohet që këto kufizime të përpunimit të përmbushen.

2. Gjatë aplikimit të paragrafit 1, shtetet anëtare nuk aplikojnë kufizimet lidhur me transmetimet e të dhënave ndaj shteteve anëtare tjera ose ndaj agjencive apo organeve të krijuara në pajtim me Titullin VI të Traktatit për Bashkimin Evropian përveç atyre që aplikohen ndaj transmetimeve nacionale të ngjashme të të dhënave.

Neni 13

Transferi te Autoritetet Kompetente në Shtetet e Treta ose te Organet Ndërkombëtare

1. Shtetet anëtare siguron që të dhënat personale të transmetuara ose të vëna në dispozicion nga autoriteti kompetent i një shteti anëtar tjetër mund të transferohen te shtetet e treta ose organet ndërkombëtare, vetëm nëse:

(a) është e nevojshme për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale ose zbatimin e dënimeve penale;

(b) autoriteti pranues në shtetin e tretë ose organi ndërkombëtar pranues është përgjegjës për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale ose zbatimin e dënimeve penale;

(c) shteti anëtar nga i cili janë marrë të dhënat, ka marrë pëlqimin e tij për transfer në pajtim me ligjin e vet nacional; dhe

(d) shteti i tretë ose organi ndërkombëtar në fjalë garanton nivel adekuat të mbrojtjes për përpunimin e synuar të të dhënave.

2. Transferimi pa pëlqim paraprak në pajtim me paragrafin 1(c) lejohet vetëm nëse transferimi i të dhënave është thelbësor për parandalimin e kërcënimit të atypëratyshëm dhe serioz ndaj sigurisë publike të një shteti anëtar ose të një shteti të tretë apo ndaj interesave esenciale të një shteti anëtar dhe pëlqimi paraprak nuk mund të merret me kohë. Autoriteti përgjegjës për të dhënë pëlqimin do të informohet pa vonesë.

3. Përmes derogimit nga paragrafi 1(d), të dhënat personale mund të transferohen nëse:

(a) ligji nacional i shtetit anëtar që transferon të dhënat parasheh kështu për shkak të:

(i) interesave specifike legjitime të subjekteve të të dhënave; ose

(ii) interesat fitues legjitimë, sidomos interesat e rëndësishme publikel ose

(b) shteti i tretë ose organi pranues ndërkombëtar parasheh ruajtje që mendohen se janë adekuate nga shteti anëtar në fjalë sipas ligjit të vet nacional.

4. Përshtatshmëria e nivelit të mbrojtjes së referuar në paragrafin 1(d) vlerësohet në saje të të gjitha rrethanave që rrethojnë veprimin e transferimit të të dhënave ose paketën e veprimeve të transferimit të të dhënave. Konsideratë e veçantë i jepet natyrës së të dhënave, qëllimit dhe kohëzgjatjes së veprimit ose veprimeve të përpunimit të propozuar, shteti i origjinës dhe shteti apo organi ndërkombëtar i destinimit të fundit të të dhënave, sundimi i ligjit, edhe i përgjithshëm edhe ai sektoral,

në fuqi në shtetin e tretë ose organi ndërkombëtar në fjalë dhe rregullat dhe masat e sigurisë profesionale që aplikohen.

Neni 14

Transmetimi te Palët Private në Shtetet Anëtare

1. Shtetet anëtare sigurohen që të dhënat personale të pranuar ose të vëna në dispozicion nga autoriteti kompetent i një shteti anëtar tjetër mund të transmetohen te palët private vetëm nëse:

(a) autoriteti kompetent i shtetit anëtar nga i cili janë marrë të dhënat ka dhënë pëlqimin për transmetim në përputhje me ligjin e vet nacional;

(b) interesat specifike të subjektit të të dhënave nuk e parandalojnë transmetimin; dhe

(c) në raste të veçanta transferimi është esencial për autoritetin kompetent që ia transmeton të dhënat një pale të tretë për:

(i) performancën e një detyre ligjërish të caktuar;

(ii) parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale ose zbatimin e dënimeve penale;

(iii) parandalimin e një kërcënimi të atypëratyshëm dhe serioz për sigurinë publike; ose

(iv) parandalimin e dëmeve serioze ndaj të drejtave të individëve.

2. Autoriteti kompetent që transmeton i të dhëna një pale private informon këtë të

fundit për qëllimet për të cilat të dhënat mund të shfrytëzohen ekskluzivisht.

Neni 15

Informimi me Kërkesë të Autoritetit Kompetent

Pranuesi, me kërkesë, informon autoritetin kompetent, i cili e ka transmetuar apo ka vënë në dispozicion të dhënat personale rreth përpunimit të tyre.

Neni 16

Informimi për Subjektin e të Dhënave

1. Shtetet anëtare garantojnë që subjekti i të dhënave të informohet lidhur me grumbullimin ose ose përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet e tyre kompetente në pajtim me ligjin nacional.

2. Kur të dhënat personale të jenë transmetuar ose vënë në dispozicion midis shteteve anëtare, çdo shtet anëtar, sipas dispozitave të ligjit të vet nacional të referuar në paragrafin 1, mund të kërkojë që shteti tjetër anëtar të mos e informojë subjektin e të dhënave. Në raste të tilla, shteti anëtar i fundit nuk e informon subjektin e të dhënave pa pëlqim paraprak të shtetit tjetër anëtar.

Neni 17

E Drejta për Qasje

1. Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtën për të marrë, pas kërkesës së bërë në intervale të arsyeshme, pa detyrim dhe pa shtyrje apo teprim të tepruar:

(a) të paktën një konfirmim nga kontrolluesi ose autoriteti mbikëqyrës nacional nëse të

dhënat që lidhen me të janë transmetuar ose vënë në dispozicion dhe informatat për pranuesit apo kategoritë e pranuesve të cilëve u janë dhënë të dhënat dhe komunikimi i të dhënave në përpunim: ose

(b) të paktën një konfirmim nga autoriteti mbikëqyrës nacional që janë bërë të gjitha verifikimet e nevojshme.

2. Shtetet anëtare mund të miratojnë masa legislative që kufizojnë qasjen në informata sipas paragrafit 1(a), ku një kufizim i tillë, me kujdes të duhur për interesat legjitimë të personit në fjalë, përbën masë të domosdoshme dhe proporcionale:

(a) për të shmangur kërkimin zyrtar ose ligjor të të dhënave, hetimet apo procedurat;

(b) për të shmangur paragjykimin e parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale ose për zbatimin e dënimeve penale;

(c) për të mbrojtur sigurinë publike;

(d) për të mbrojtur sigurinë nacionale;

(e) për të mbrojtur subjektin e të dhënave ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

3. Çfarëdo refuzimi apo kufizimi i qasjes i paraqitet me shkrim subjektit të të dhënave. Në të njëjtën kohë, arsyet faktike dhe ligjore mbi të cilat bazohet vendimi i komunikohen atij. Komunikimi i fundit mund të mënjanohet kur ekziston një arsye sipas paragrafit 2(a) deri (e). Në të gjitha këto raste subjekti i të dhënave informohet se mund të apelojë te autoriteti mbikëqyrës nacional kompetent, te një autoritet gjyqësor ose te një gjykatë.

Neni 18

E Drejta për Korrigjim, Fshirje ose Bllokim

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të presë nga kontrolluesi që të përmbushë detyrat e tij në pajtim me nenin 4, 8 dhe 9 për sa i përket korrigjimit, fshirjes ose bllokimit të të dhënave personale që dalin nga ky vendim kornizë. Shtetet anëtare deklarojnë nëse subjekti i të dhënave mund ta kërkojë këtë të drejtë në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj kontrolluesit ose përmes ndërmjetësit të autoritetit mbikëqyrës kompetent nacional. Nëse kontrolluesi refuzon korrigjimin, fshirjen ose bllokimin, refuzimi duhet t'i komunikohet me shkrim subjektit të të dhënave i cili duhet të informohet për mundësitë e parapara në ligjin nacional për paraqitjen e kërkesës ose për kërkimin e këshillës gjyqësore. Me ekzaminimin e ankesës ose këshillës gjyqësore, subjekti i të dhënave informohet nëse kontrolluesi ka vepruar ashtu si duhet apo jo. Shtetet anëtare gjithashtu mund të parashohin që subjekti i të dhënave informohet nga autoriteti mbikëqyrës kompetent nacional që është shqyrtuar.

2. Nëse saktësia e një pike të të dhënave personale kontestohet nga subjekti i të dhënave dhe saktësia apo pasaktësia e tij nuk mund të përcaktohet, mund të bëhet referencimi i asaj të dhëne.

Neni 19

E Drejta për Kompensim

1. Çdo person që është dëmtuar si rezultat i veprimit të përpunimit të ligjshëm ose i një akti të mospërputhshëm me dispozitat

nacionale të miratuara sipas këtij vendimi kornizë, ka të drejtë të marrë kompensim për dëmin e përjetuar nga kontrolluesi ose autoriteti tjetër kompetent sipas ligjit nacional.

2. Atëherë ku autoriteti kompetent i shtetit anëtar ka transmetuar të dhëna personale, në kontekst të përgjegjësisë së vet ndaj palës së dëmtuar sipas ligjit nacional, pranuesi nuk mund ta citojë në mbrojtjen e tij që të dhënat e transmetuara ishin të pasakta. Nëse pranuesi paguan kompensim për dëmtimet e shkaktuara me përdorimin e të dhënave të transmetuara në mënyrë jo korrekte, autoriteti transmetues kompetent ia kthen paratë pranuesit të paguar për dëmet, duke marrë parasysht çfarëdo gabimi që mund të jetë bërë nga pranuesi.

Neni 20

Këshilla Gjyqësore

Pa paragjykuar ndonjë kompensim administrativ për të cilin përgatitja mund të bëhet para se t'i referohet autoritetit gjyqësor, subjekti i të dhënave ka të drejtë në kompensim gjyqësor për çfarëdo shkelje të të drejtave të garantuara me ligjin e aplikueshëm nacional.

Neni 21

Konfidencialiteti i Përpunimit

1. Çdo person që ka qasje në të dhënat personale që bien në kuadër të këtij vendimi kornizë mund të përpunojë të dhëna të tilla nëse ai person është anëtar i autoritetit kompetent, apo vepron sipas udhëzimeve të tij, veç nëse i kërkohet me ligj të veprjë ashtu.

2. Personat që punojnë për autoritetin kompetent të shtetit anëtar do t'i nënshtrohen të gjitha rregullave të mbrojtjes së të dhënave që aplikohen nga autoriteti kompetent në fjalë.

Neni 22

Siguria e Përpunimit

1. Shtetet anëtare parashohin se autoritete kompetente duhen zbatuar masat e duhura teknike dhe organizative për ti mbrojtur të dhënat personale ndaj asgjësimit aksidental apo të paligjshëm ose humbjes aksidentale, modifikimit, publikimit ose qasjes së paautorizuar, sidomos kur përpunimi përfshinë transmetimin përmes rrjetit ose vënien në dispozicion duke i dhënë drejtpërdrejt qasje automatike, dhe ndaj të gjitha formave të paligjshme të përpunimit, duke marrë parasysh në veçanti rreziqet e përfaqësuara nga përpunimi dhe natyra e të dhënave që duhen mbrojtur. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të zhvillimit teknologjik si dhe koston e zbatimit të tij, masat e tilla garantojnë një nivel të sigurisë, të përshtatshëm me rrezikun e përfaqësuar nga përpunimi dhe në natyra e të dhënave që duhen mbrojtur.

2. Për sa i përket përpunimit të automatizuar të të dhënave, çdo shtet anëtar i zbaton masat e përcaktuara për të:

(a) refuzuar qasjen e personave të paautorizuar në pajisjet e përpunimit të të dhënave që përdoren për të përpunuar të dhëna personale (kontrolli i qasjes në pajisje);

(b) parandaluar leximin e paautorizuar, kopjimin, modifikimin apo largimin e

mediemeve të të dhënave (kontrolli i mediemeve të të dhënave);

(c) parandaluar inputet e paautorizuara të të dhënave dhe inspektimin e paautorizuar, modifikimin ose fshirjen e të dhënave personale të ruajtura (kontrolli i ruajtjes);

(d) parandaluar përdorimin e sistemeve automatike të përpunimit të të dhënave nga personat e paautorizuar që përdorin pajisjet e komunikimit të të dhënave (kontrolli i përdoruesve);

(e) siguruar që personat e autorizuar për të shfrytëzuar një sistem të automatizuar të përpunimit të të dhënave që të kenë qasje në të dhënat e mbuluara me autorizimin e qasjes së tyre (kontrolli i qasjes në të dhëna);

(f) siguruar që është e mundur për të verifikuar dhe vendosur se te cilat organe janë transferuar të dhënat personale apo mund të transferohen ose janë vënë në dispozicion duke shfrytëzuar pajisjet e komunikimit të të dhënave (kontrolli i komunikimit);

(g) siguruar që më pas të jetë e mundur të verifikohet dhe vendoset se cilat të dhëna personale janë futur në sistemet e përpunimit automatik të të dhënave dhe se kur e nga kush janë futur të dhënat (kontrolli i futjes së të dhënave);

(h) parandaluar leximin, kopjimin, modifikimin ose fshirjen e paautorizuar të të dhënave personale gjatë transferimeve të të dhënave personale ose gjatë transportimit të mediemeve të të dhënave (kontrolli i transportimit);

(i) siguruar që sistemet e instaluara, në rast ndërhyrjeje, mund të kthehen (kthimi);

(j) siguruar që funksionet e sistemit të funksionojnë, që paraqitja e të metave në funksione të raportohet (besueshmëria) dhe që ato të dhëna të ruajtura nuk mund të korruptohen me mjete të mosfunksionimit të sistemit (papakshmëria).

3. Shtetet anëtare parashikojnë që përpunuesit mund paracaktohen vetëm nëse garantojnë se i zbatojnë masat e kërkuara teknike dhe organizative sipas paragrafit 1 dhe janë në përputhje me udhëzimet sipas nenit 21. Autoriteti kompetent monitoron përpunuesin në këtë aspekt.

4. Të dhënat personale mund të përpunohen nga përpunuesi vetëm në bazë të një akti ligjor apo një kontrate me shkrim.

Neni 23

Konsultimi Paraprak

Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet mbikëqyrëse kompetente nacionale të konsultohen para përpunimit të të dhënave personale që do të përbëjnë pjesë të një sistemi të ri të dosjeve që duhet krijuar në rastet kur:

(a) duhet përpunuar kategori të veçanta të të dhënave të referuara në nenin 6; ose

(b) lloji i përpunimit, sidomos ai që shfrytëzon teknologjitë e reja, mekanizmat ose procedurat, përndryshe bartë rreziqe specifike për të drejtat dhe liritë fundamentale, dhe në veçanti për privatësinë e subjektit të të dhënave.

Neni 24

Dënimet

Shtetet anëtare miratojnë masa të përshtatshme për të siguruar zbatimin e plotë të dispozitave të këtij vendimi kornizë dhe në veçanti parashtron dënime proporcionale, efektive dhe zbindëse për t'u shqiptuar në rast shkeljesh së dispozitave të miratuara sipas këtij vendimi kornizë.

Neni 25

Autoritetet Mbikëqyrëse Nacionale

1. Çdo shtet anëtar parasheh që një apo më shumë autoritete publike të jenë përgjegjëse për këshillimin dhe monitorimin e zbatimit të dispozitave të miratuara nga shtetet anëtare brendapërbrenda territorit të tyre, në pajtim me vendimin kornizë. Këto autoritete veprojnë me pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve të besuara.

2. Çdo autoritet në veçanti pajiset me:

(a) kompetenca hetuese, siç janë kompetencat për qasje në të dhënat që formojnë lëndën e operimeve përpunuese dhe kompetencat për të grumbulluar tërë informatat e nevojshme për përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes;

(b) kompetenca efektive të intervenimit, siç janë, për shembull, atë të dhënies së opinionëve para se të kryhen operimet e përpunimit, dhe të garantojë publikimin e duhur të opinionëve të tilla, të urdhërimit të bllokimit, fshirjes ose asgjësimit të të dhënave, të imponimit të ndalesës së përkohshme apo definitive të përpunimit, të paralajmërimit ose të

këshillimit/paralajmërimit të kontrolluesit, ose atë të referimit të lëndës te parlamentet nacionale ose institucionet tjera politike.

(c) kompetencën për t'u angazhuar në procedura ligjore ku dispozitat navionale të miratuara sipas këtij vendimi kornizë janë shkelur ose që ta paraqesë këtë shkelje para autoriteteve gjyqësore. Vendimet e autoritetit mbikëqyrës që ngrisin ankesat mund të ankimohet përmes gjykatave.

3. Çdo autoritet mbikëqyrës dëgjon ankesat e paraqitura nga cilido person për sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tij lidhur me përpunimin e të dhënave personale. Personi në fjalë informohet për rezultatin e ankesës.

4. Shtetet anëtare parashohin që anëtarët dhe stafi i autoritetit mbikëqyrës i nënshtrohen dispozitave të mbrojtjes së të dhënave të aplikueshme ndaj autoritetit kompetent në fjalë, edhe pas përfundimit të punësimit të tyre, dhe i nënshtrohen detyrës së fshehtësisë profesionale për sa i përket informatave konfidenciale në të cilat kanë qasje.

Neni 26

Marrëdhënia Kontraktuale me Shtetet e Treta

Ky vendim kornizë nuk paragjykon asnjë obligim dhe përkushtim që i takojnë shteteve anëtare ose Bashkimit duke u mbështetur në marrëveshjet bilaterale dhe/ose multilaterale me shtetet e treta që ekzistojnë në kohën e miratimit të këtij vendimi kornizë.

Në zbatim të këtyre marrëveshjeve, transferi i të dhënave personale në një shtet të tretë, të marra nga një shtet tjetër anëtar, kryhet duke respektuar nenin 13(1)(c) ose (2) siç është e përshtatshme.

Neni 27

Vlerësimi

1. Shtetet anëtare i raportojnë Komisionit deri më 27 nëntor 2013 për masat nacionale që i kanë marrë për të garantuar pajtim të plotë me këtë vendim kornizë, e në veçanti për sa i përket këtyre dispozitave që veçse është dashur të jenë të përshtatura kur të mblidhen të dhënat. Komisioni teston sidomos implikimet e atyre dispozitave për fushëveprimin e këtij vendimi kornizë siç është paraqitur në nenin 1(2).

2. Komisioni i raporton Parlamentit Evropian dhe Këshillit brenda një viti, rreth rezultatit të vlerësimit të referuar në paragrafin 1, dhe e shoqëron raportin e vet me ndonjë propozim të përshtatshëm për amandamentime të këtij vendimi kornizë.

Neni 28

Marrëdhënia me Aktet e Miratuara më parë të Bashkimit

Në rastet kur prezentohen kushte të veçanta për përdorimin e të dhënave të tilla nga shteti anëtar pranues në aktet e miratuara sipas Titullit VI të Traktatit për Bashkimin Evropian para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi kornizë dhe që rregullon shkëmbimin e të dhënave personale midis shteteve anëtare ose qasjen e autoriteteve të përcaktuara të shteteve anëtare ndaj sistemeve informative të krijuara sipas Traktatit që themelon Komunitetin

Evropian, këtyre kushteve u jepet përparësi në raport me dispozitat e këtij vendimi kornizë rreth përdorimit të të dhënave të pranuar apo të vëna në dispozicion nga një shtet anëtar tjetër.

Neni 29

Zbatimi

1. Shtetet anëtare ndërmarrin masat e nevojshme për të qenë në përputhje me dispozitat e këtij vendimi kornizë para 27 nëntorit 2010.

2. Deri në të njëjtën datë, shtetet anëtare ia transmetojnë Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit dhe Komisionit tekstin e dispozitave që zhvendosin brenda ligjit të tyre nacional obligimet e ngarkuara sipas këtij vendimi kornizë, si dhe informatat mbi autoritete mbikëqyrëse të referuara në nenin 25. Në bazë të një raporti të krijuar që shfrytëzon këto informata nga Komisioni, para 27 nëntorit 2011, Këshilli vlerëson nivelin deri në të cilin shtetet anëtare i kanë zbatuar dispozitat e këtij vendimi kornizë.

Neni 30

Hyrja në fuqi

Ky vendim kornizë hyn në fuqi në ditën e 20-të pas publikimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Bruksel, 27 nëntor 2008

Për Këshillin

Presidenti

M. ALLIOT-MARIE